



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 7, datë 21.06.2024

“Për përfaqësimin e disa Institucioneve që veprojnë në sektorë me risk për korrupsion me përfaqësues/ekspertë pranë Nëngrupit të punës për Antikorrupsion të ngritur në Komisionin e Posaçëm Parlamentar”

Bazuar në nenet 24 dhe vijues të Regullores së Kuvendit dhe në pikën VIII, paragrafi 2, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 1/2024 të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. T’u drejtohet institucioneve publike të cilat ushtrojnë funksionet, sipas vlerësimit të bërë në Raportet e BE, në fusha me risk për korrupsion si në prokurime publike, prona, arsim, shëndetësi, tatime, dogana etj. (Lista bashkëlidhur), që të propozojnë përfaqësuesit/ekspertët me të cilët do të përfaqësohen për të bashkëpunuar dhe kontribuar me ekspertizën e tyre pranë Nëngrupit të punës për Antikorrupsion të ngritur në GE pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
2. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar institucioneve të sipërpërmendura vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin dhe kohën e veprimtarisë së tij si dhe kriteret e cilësitë e domosdoshme që duhet të përmbushin përfaqësuesit/ekspertët e tyre për t’u përfshirë në këtë proces.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Fatmir XHAFAJ

Miratuar më 21.06.2024

Lista 1

1. Agjencia e Prokurimit Publik
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit
3. Agjencia Shtetere e Kadastres
4. Komisioni Prokurimit Publik
5. Ministria e Financave
6. Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale